



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM

Nr. 74, datë 04.03.2021

**PËR
MIRATIMIN E “RAPORTI I PUNËS SË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË ETIKËS
DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE PËR VITIN 2020”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në pikën 16, të nenit 62 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për vitin 2020,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raporti i punës së Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale për vitin 2020”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE

**RAPORT I PUNËS SË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE
VEPRIMTARISË PROFESIONALE PËR VITIN 2020**

**DREJTUAR : MBLEDHJES PLENARE TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR**

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE	3
II. RAPORTIM MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT	4
A. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE	4
B. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E RREGULLAVE TË BRENDSHME	6
C. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR TRAJTIMIN E KËRKESAVE TË GJYQTARËVE DHE INTITUCIONEVE DHE HARTIMIN E AKTEVE ADMINISTRATIVE INDIVIDUALE	9
D. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT PËR GJYQTARET	10
a. Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradim) për periudhën e vlerësimit 2013-2016.	11
b. Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik	12
c. Faktorë që kanë ndikuar në ecurinë e procesit të vlerësimit në vitin 2020	14
E. ÇËSHTJE TË TJERA	15
III. OBJEKTIVAT E KVEVP PËR VITIN 2021	15

I. HYRJE

Raporti vjetor i punës së KVEVP hartohet në bazë të parashikimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 62 pika 16 të të cilit

parashikohet se: “16. Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.”.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (në vijim Komisioni) është një ndër katër Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me vendimin nr.13 datë 18.1.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor janë zgjedhur anëtarë të përhershëm të Komisionit znj. Brikena Ukperaj (Lubonja), znj. Brunilda Kadi, z. Erjon Muharremaj dhe anëtarë zëvendësues znj.Fatmira Luli dhe z. Medi Bici. Ky Komisionin ushtron funksionet sipas përcaktimeve të nenit 62 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky Komision është asistuar përgjatë vitit 2020, nga tre këshilltaret ligjore znj.Rudina Palloj, znj.Alsma Shehu dhe znj.Rezarta Taushani, për të cilat vlerësimi i punës nga të tre anëtarët e Komisionit, është maksimal.

Gjatë vitit 2020, Komisioni ka organizuar punën me qëllim përmbushjen e funksioneve, duke zhvilluar veprimtarinë e tij në disa drejtime, si më poshtë :

- Hartimin, diskutimin dhe paraqitjen për miratim të akteve nënligjore normative dhe kolektive që përfshijnë fushën e veprimtarisë së KVEVP si dhe veprimtari të tjera, në bashkëpunim me Komisionet e tjera të përhershme dhe të përkohshme të Këshillit;
- Trajtimin e kërkesave të gjyqtarëve drejtuar Këshillit për çështje që janë në fushën e veprimtarisë së KVEVP dhe paraqitjen e tyre pranë Këshillit për vendimmarrje;
- Administrimin e kërkesave të gjyqtarëve për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit;
- Dhënien e opinionit për ndryshime ligjore të propozuara;
- Trajtimin e vazhdueshëm të dokumentacionit dhe praktikave të kaluara pranë Komisionit;
- Fillimin dhe zhvillimin e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për periudhat e vlerësimit 2013-2016 dhe për periudhën e vlerësimit viti 2019.

II. RAPORTIM MBI VEPRIMTARINË E KOMISIONIT

A. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE

Gjatë punës një vjeçare, Komisioni është angazhuar në procesin e hartimit, diskutimit dhe paraqitjes për miratim pranë Këshillit të një sërë aktesh nënligjore në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Konkretisht, gjatë vitit 2020 Komisioni ka hartuar dhe paraqitur për miratim aktet nënligjore si më poshtë:

1. ***Projekt-akti “Udhëzues për plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, miratuar me vendimin nr.60 datë 30.1.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

Hartimi dhe miratimi i këtij Udhëzuesi ka ardhur si domosdoshmëri, pas miratimit të tabelave me të dhëna statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, miratuar me vendimin nr. 316 datë 19.12.2019, të cilat janë dërguar në çdo gjykatë për gjyqtarët e përfshirë në programin vjetor të vlerësimit për vitin 2020. Nëpërmjet këtij akti është detajuar mënyra e plotësimit të tabelave me të dhëna statistikore me qëllim unifikimin e mënyrës së plotësimit të tyre, për të përfutur të dhëna të sakta dhe të dobishme për vijimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve.

2. Projekt-akti “Për miratimin e Formularit të Integruar të Vlerësimit të Gjyqtarit” miratuar me vendimin nr.120 datë 5.3.2020 datë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me qëllim plotësimin e akteve të skemës së vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, është hartuar “Formuari i integruar i vlerësimit të gjyqtarit”, në të cilin pasqyrohet vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi përfundimtar i kryetarit, të cilët janë burime vlerësimin në zbatim të nenit 77 shkronja “ç” dhe “d”, të “Ligjit për Statusin”. Hartimi i këtij formulari ka për qëllim përcaktimin e formatit mbi bazën e të cilit gjyqtari bën vetëvlerësimin e tij në referim të nenit 86 të “Ligjit për Statusin”, përcaktimin e formatit mbi bazën e të cilit kryetari i gjykatës jep mendimin përfundimtar, për efekt të vlerësimit të gjyqtarit në referim të nenit 87 të “Ligjit për Statusin” si dhe përcaktimin e standardeve të mendimit të kryetarit në referim të parashikimeve të nenit 87 pika 1 të “Ligjit për statusin”. Drafti paraprak i formularit i është nënshtruar diskutimit me kryetarët e gjykatave në takimin e zhvilluar më datë 21.2.2020, duke reflektuar sugjerimet dhe mendimet e përcjella prej tyre lidhur me formatin dhe përmbajtjen e formularit. Modeli i formularit elektronik të miratuar ka përmbyllur procesin e hartimit dhe testimit të tij, proces i zhvilluar nga ekspertë të Euralius V në bashkëpunim me KVEVP dhe disa gjyqtarë të cilët kanë bashkëpunuar gjatë fazës së testimit të formularit elektronik, para miratimit të formës përfundimtare të tij.

3. Projekt-akti për miratimin e “Rregullave për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, i miratuar me vendimin nr. 197 datë 11.6.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Hartimi dhe miratimi i këtij akti, pjesë e Skemës së Vlerësimit, ka për qëllim përcaktimin e rregullave të përzgjedhjes së çështjeve me short, procedurën e zhvillimit dhe dokumentimit të shortit për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim, në zbatim të nenit 91 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 263 datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”.

4. Projekt-akti “Për krijimin e njësive të shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit”, miratuar me vendimin nr.495, datë 21.10.2020.

Hartimi dhe miratimi i këtij projekt-akti, në zbatim të nenit 42 të ligjit nr. 98/2016, nëpërmjet krijimit të njësive të shërbimit ligjor në gjykatat e apelit, i ka hapur rrugën plotësimit të njësive me ndihmësit ligjore që janë aktualisht në sistem por edhe me ndihmësit që kanë përfunduar

programin e formimit fillestar, duke synuar rritjen e efikasitetit në ndihmë të ushtrimit të veprimtarisë gjyqësore.

B. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E RREGULLAVE TË BRENDSHME

5. Projekt-akti “Për shfuqizimin e pezullimit të procedurës së komandimit për pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin”, miratuar me vendimin nr. 22 datë 14.1.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky akt, vjen pas pezullimit të procedurës së komandimit për pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin, me vendimin nr. 205, datë 11.10.2019 deri në përfundim të shqyrtimit të statusit të ish inspektorëve dhe përbërjen e Njesisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve. Mbi bazën e këtij akti ka vijuar procedura për komandimin e dy gjyqtarëve në pozicionin “Nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve.

6. Projekt-akti “Për miratimin e modelit të procesverbalit “Për pasqyrimin e veprimeve që kryhen gjatë procedurës së përzgjedhjes me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, miratuar me vendimin nr. 232, datë 2.7.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pas miratimit të vendimit nr. 197, datë 11.6.2020 që përcakton “Rregullat për përzgjedhjen me short të çështjeve në procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, është hartuar modeli i procesverbalit për pasqyrimin e veprimeve të procedurës së shortit për përzgjedhjen e çështjeve për vlerësim, me qëllim pasqyrimin e saj sipas një forme standarde dhe të unifikuar, sipas parashikimeve të nenit 13 pika 6 të vendimit nr. 263 datë 21.11.2019 “Rregulla plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, dhe pikës 19 të Vendimit nr. 197, datë 11.6.2020. Hartimi dhe miratimi i modelit të procesverbalit sipas të cilit do të pasqyrohen veprimet që kryhen gjatë procedurës së përzgjedhjes të çështjeve me short, ka për qëllim dokumentimin e plotë dhe të saktë të procedurës së shortit si dhe garantimin e rregullshmërisë dhe transparencës në zhvillimin e kësaj procedure.

7. Projekt-akti “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, krëteret dhe procedurën e komandimit”, akt i cili është paraqitur si bashkë propozim me Komisionin e Zhvillimit të Karrierës dhe është miratuar me vendimin nr. 400, datë 07.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky akt, si një bashkë propozim me Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, ka ardhur për shkak të nevojës emergjente për të plotësuar strukturën e Njesisë së Vlerësimit Etik dhe Profesional pranë KLGj, njësi që mbështet dy komisionet e Këshillit, Komisionin e Përhershëm të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe Komisionin e Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar. Mbi bazën e këtij akti është zhvilluar

procedura për komandimin e një gjyqtari në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Etik dhe Profesional.

8. Projekt-akti “Për miratimin e modelit të hartimit të raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”, miratuar me vendimin nr.531, datë 28.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Hartimi dhe miratimi i modelit mbi bazën e të cilit do të hartohet raporti analitik nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin ka për qëllim standardizimin e mënyrës së hartimit të raportit, përfshirjen e të gjitha burimeve të vlerësimit, evidentimin në mënyrë të strukturuar të të dhënave që rezultojnë prej tyre në raport me treguesit që i përkatësin secilit nga katër kriteret e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, si dhe përcaktimin e përmbajtjes që duhet të ketë raporti për çdo tregues, duke përcaktuar sipas treguesit nëse nëpunësi duhet të evidentojë të dhënat nëpërmjet përshkrimit dhe/ose analizës së tyre.

9. Projekt-akti “Për krijimin e bazës së të dhënave në Gjykatën e Lartë dhe dhënien e autorizimit për akses në sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore”, miratuar me vendimin nr. 540, datë 05.11.2020.

Ky akt është hartuar në bashkëpunim me Komisionin e Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, në funksion të detyrimit ligjor që ka Këshilli për mirëmbajtjen dhe administrimin e bazës së të dhënave në gjykata, me qëllim lehtësimin e punës së Gjykatës së Lartë në evadimin e shpejtë të çështjeve gjyqësore të akumuluar dhe shërbimit në kohë ndaj publikut. Iniciues i këtij akti ka qenë vetë Gjykata e Lartë, e cila i ka propozuar Këshillit krijimin e bazës së të dhënave gjyqësore pranë kësaj gjykate. Ky vendim, duke i dhënë mundësinë e krijimit të një sistemi elektronik Gjykatës së Lartë, bën të mundur aksesimin në programin word të vendimmarrjes së gjykatave të shkallëve të para dhe apelit, në favor të ekonomisë gjyqësore dhe për pasojë edhe shqyrtimin e një numri më të madh vendimmarrjesh, duke shmangur hedhjen manuale të të dhënave nga çështjet gjyqësore në shqyrtim.

10. Projekt-akti “Për miratimin e modelit të hartimit të projektraportit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit”, miratuar me vendimin nr.591, datë 26.11.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), ka miratuar një sërë aktesh nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve. Një nga këto akte është vendimi nr. 263 datë 21.11.2019, me anë të së cilit janë miratuar rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve. Në këtë vendim është parashikuar që dy prej akteve të rëndësishme që finalizojnë punën e vlerësuesve, raporti analitik dhe projekt-raporti i vlerësimit, të përpilohen sipas një forme standarde, një modeli që duhet të miratohet nga Mbledhja Plenare. Hartimi i modelit mbi bazën e të cilit do të hartohet projektraporti i vlerësimit nga relatori, ka për qëllim standardizimin e mënyrës së hartimit të tij, përfshirjen e të gjithë elementëve të domosdoshëm që

duhet të përmbajë projektraporti sipas parashikimeve të nenit 93, pika 5 të Ligjit për Statusin si dhe përcaktimin dhe strukturimin e përmbajtjes për çdo pjesë të këtij projektraporti.

11. Projekt-akti “Për miratimin e planit strategjik të komunikimit për sistemin gjyqësor” miratuar me vendimin nr. 590, datë 26.11.2020.

Hartimi dhe miratimi i “Planit strategjik të komunikimit për sistemin gjyqësor”, ka për qëllim përcaktimin e bazave për përmirësimin e marrëdhënieve të gjyqësor me median dhe publikun, garantimin e përmirësimit të aksesit, të kuptuarit dhe besimit të publikut tek gjykatat dhe të kuptuarit prej publikuar të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat. Ky akt synon të garantojnë parimet udhëheqëse të komunikimit të sistemit gjyqësor, aksesin, komunikimin profesional, besueshmërinë, përgjegjësinë, transparencën, ndershmërinë, llogaridhënien si dhe angazhimin e KLGJ për rikthimin e besimit të publiku në sistemin gjyqësor si dhe harmonizimin e komunikimit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për mediat, të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale, etj. Nëpërmjet këtij Plani Strategjik KLGJ ka përcaktuar vizionin, misionin dhe vlerat thelbësore të gjyqësorit, qëllimet e komunikimit, monitorimin, alokimin e burimeve, përcaktimin e rolit të Këshillit në zbatimin e parimeve të komunikimit, rolin e gjyqtarit të medias dhe nëpunësit për marrëdhëniet me median dhe publikun në zbatimin e parimeve të komunikimit, bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin e aktorëve që do të zbatojnë Strategjinë, rolin e faqeve të internetit të gjykatave, mediave sociale, etj. Plani strategjik i komunikimit për sistemin gjyqësor është hartuar me mbështetjen dhe ndihmën vazhdueshme të ekspertëve të projektit “Justice for all” të USAID.

12. Projekt-akti për miratimin e “Rregullores për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median”, miratuar me vendimin nr. 592, datë 26.11.2020.

Hartimi i “Rregullores për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median”, në referim të nenit 147/a të Kushtetutës dhe nenit 91 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, ka për qëllim përcaktimin e parimeve, rregullave dhe procedurave të veçanta për marrëdhëniet e Këshillit me publikun, komunikimin e lirshëm, transparent, të përgjegjshëm dhe profesional me median si dhe lehtësimin e vështirësive për aksesimin e lajmit për komunitetin e mediave dhe gazetarëve.

13. Projekt-akti “Për miratimin e programit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2021” miratuar me vendimin nr. 645, datë 23.12.2020.

Hartimi dhe miratimi i Programit të Vlerësimit Etik dhe Profesional sipas parashikimeve të nenit 85/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ka pasur për qëllim miratimin e programit me listën e gjyqtarëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit pasardhës, bashkë me përcaktimin e periudhës së vlerësimit. Qëllimi i këtij programi është përgatitja paraprakisht e një plani pune me emrat e gjyqtarëve që do të vlerësohen përgjatë vitit 2021 duke iu shërbyer gjithashtu Kryetarëve e Kancelarëve të gjykatave, që të organizojnë punën për plotësimin e tabelave statistikore e dërgimin e tyre në KLGJ, brenda muajit janar, para se të fillojë procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar të përfshirë në këtë listë. Programi i Vlerësimeve për vitin 2021 përmban katër pjesë:

- Gjendjen e procedurave të vlerësimit të filluara gjatë vitit 2020, sipas programit të miratuar për këtë vit;
- Përcaktimin e listës së gjyqtarëve dhe periudhës së vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2021, listë ne të cilën janë përfshirë 52 gjyqtarë, duke përfshirë gjyqtarët të cilët janë aktualisht në procedure vlerësimi të përsheptuar të detyruar viti kalendarik 2019, kanë qenë të komanduar si ndihmësmagjistratë në Gjykatën e Lartë gjatë periudhës së vlerësimit 2017-2019 ose kanë qenë të komanduar në KLGJ gjatë periudhës së vlerësimit 2017-2019;
- Planifikimin 3/mujor të vlerësimeve individuale, bazuar në nenin 11 pika 1 të vendimit nr. 263, dt. 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”. Në këtë drejtim, duke marrë ne konsideratë faktin që ky është programi i dytë i vlerësimeve pas krijimit të KLGJ-së, situatën në të cilën ndodhen gjykatat për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar si dhe për shkak të pezullimit ose reduktimit të herë pas herëshëm të veprimtarisë për shkak të pandemisë, vendet vakante që mund të hapen, kërkesat për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele... etj., KLGJ ka vlerësuar se planifikimet 3/mujore të vlerësimeve të miratohen me vendim të veçantë të Këshillit, mbi bazën e të cilit do të fillojë edhe procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar si dhe të fillojnë në muajin Mars 2021 duke u ndarë në 3 programe të veçanta 3/mujore në mënyrë që muajt e parë të vitit 2021 të shërbejnë për përfundimin e procedurave të vlerësimit të filluara në vitin 2020.
- Prioritetet e planifikimeve 3/mujore.

C.

V

EPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR TRAJTIMIN E KËRKESAVE TË GJYQTARËVE DHE INTITUCIONEVE DHE HARTIMIN E AKTEVE ADMINISTRATIVE INDIVIDUALE

Gjatë punës një vjeçare Komisioni ka trajtuar kërkesat e gjyqtarëve dhe/ose Institucioneve përkatëse në lidhje me, kërkesat për leje, përjashtim nga procedurat e shortit, etj. Këto kërkesa janë trajtuar nga Komisioni i cili pasi ka zhvilluar procedurën administrative, në rastet kur trajtimi i tyre është vlerësuar se duhet të finalizohet nëpërmjet vendimmarrjes, ka përgatitur propozimet përkatëse për Mbledhjen Plenare. Konkretisht, gjatë vitit 2020, janë trajtuar dhe miratuar aktet administrative individuale si më poshtë:

- 14.** Vendim nr. 23, datë 14.1.2020 “Për komandimin e gjyqtares znj. Gilda Hoxha në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.
- 15.** Vendim nr. 24, datë 14.1.2020 “Për komandimin e gjyqtares znj. Esmerilda Habili në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.
- 16.** Vendim nr. 68, datë 6.2.2020 “Për komandimin e gjyqtares znj. Marinela Osmani në pozicionin e këshilltarit ligjor në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve të Përhershme në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.
- 17.** Vendim nr. 453, datë 19.10.2020 “Për komandimin e gjyqtares znj. Zeta Tërpollari në pozicionin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

18. Vendim nr. 522, datë 27.10.2020 “Për zëvendësimin e nëpunësit përgjegjës për vlerësimin z. Fatbardh Çoniku në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”.
19. Vendim nr. 530, datë 28.10.2020 “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtares Evjeni Sinojmeri për dhënie leje shtesë të papaguar”.
20. Vendim nr. 549, datë 12.11.2020 “Për miratimin e kërkesës së gjyqtares Suela Lika për dhënie leje të papaguar”.
21. Vendim nr. 550, datë 12.11.2020 “Për miratimin e kërkesës së gjyqtares Alda Sadiku për dhënie leje të papaguar”.

Në kuadër të bashkëpunimit më Shkollën e Magjistraturës për realizimin e programit të formimit fillestar dhe vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, janë trajtuar kërkesat e Shkollës së Magjistraturës duke u miratuar me vendimet si më poshtë:

22. Vendim nr. 59, datë 30.1.2020 “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën janar-mars 2020”.
23. Vendim nr. 167, datë 28.5.2020 “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën prill-qershor 2020”.
24. Vendim nr. 494, datë 21.10.2020 “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën tetor-dhjetor 2020”.
25. Vendim nr. 647, datë 23.12.2020 “Për miratimin e pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për periudhën janar-mars 2021”.
26. Vendimi nr. 73, datë 20.02.2020 “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (për zëvendësimin e magjistratit gjyqtar udhëheqës).
27. Vendimi nr. 123, datë 05.03.2020 “Për një ndryshim në vendimin nr. 112, datë 09.07.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” (për zëvendësimin e magjistratit gjyqtar udhëheqës).

D. VEPRIMTARIA E KOMISIONIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT PËR GJYQTARET

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në zbatim të nenit 171 pika 5 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”, ka administruar dosjet me aktet e vlerësimit profesional për gjyqtarët që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, përcjellë nga organet e rivlerësimit pranë Këshillit, pasi vendimet respektive për secilin gjyqtar kanë marrë formë të prerë.

a. Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradim) për periudhën e vlerësimit 2013-2016.

Për të gjithë gjyqtarët për të cilët vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar ka marrë formë të prerë dhe janë përcjellë dosjet përkatëse pranë Këshillit, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimi) me vendimet si më poshtë:

- 28. Vendim nr. 198, datë 11.06.2020** “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”.
- 29. Vendim nr. 233, datë 02.07.2020** “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”.
- 30. Vendim nr. 336, datë 24.9.2020** “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”.
- 31. Vendim nr. 644 datë 23.12.2020** “Për fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit”.

Nëpërmjet këtyre vendimeve ka filluar procedura e vlerësimit si dhe janë përcaktuar me short relatori dhe nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, për gjyqtarët e mëposhtëm:

- Albana Boksi – Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Daniela Shirka - Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Dhimitër Lara - Gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Eriol Roshi – Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Enton Dhimitri – Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër;
- Emona Muçi – Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
- Gentian Medja - Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Iliriana Olldashi - Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Klodian Kurushi - Gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Klodiana Veizi - Gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;
- Manjola Xhaxho – Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Margarita Buhali - Gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë;
- Miliana Muça - Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Nertina Kosova - Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Ornela Naqellari – Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit gjyqësor Lezhë;

- Saida Dollani - Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Sokol Binaj - Gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Sokol Ibi – Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë;
- Asim Vokshi - Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- Artur Kalaja - Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- Esmeralda Xhili (Çeka) – Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje;
- Rexhep Bektashi – Gjyqtar pranë Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës;
- Sandër Simoni – Gjyqtar pranë Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Edlira Petri – Gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- Alma Kolgjoka- Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë;
- Blerona Hasa- Gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit;
- Ridvan Hado- Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

b. Fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të përsheptuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik.

Lidhur me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, sipas Programit të Vlerësimeve të vitit 2020, të miratuar me vendimin nr. 276 datë 10.12.2019, ka filluar procedura e vlerësimit të përsheptuar të detyruar etik dhe profesional për vitin e fundit të ushtrimit të detyrës (viti kalendarik 2019), e cila përbën përparësi në procedurat e vlerësimit të gjyqtarëve, për të gjithë gjyqtarët që kanë kandiduar për ngritje në detyrë dhe kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit, me vendimet si më poshtë:

- 32. Vendim nr. 247, datë 09.07.2020** “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë.”
- 33. Vendim nr. 314, datë 14.09.2020** “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë.”
- 34. Vendim nr. 337, datë 24.9.2020** “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë.”
- 35. Vendim nr. 634 datë 16.12.2020** “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtarët që kanë plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë.”
- 36. Vendim nr. 635 datë 16.12.2020** “Për fillimin e procedurës së përsheptuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2017-2019, për gjyqtaren Lutfije Celami, e cila ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit.”

Me vendimet e mësipërme, KLGJ ka filluar procedurën e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, për vitin 2019 dhe në një rast vlerësimin për periudhën 3 vjeçare (2017-2019), si dhe janë përcaktuar me short relatori dhe nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, për 42 gjyqtarë, si më poshtë:

- Albana Boksi – Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Dhimitër Lara - Gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Enton Dhimitri – Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë;
- Gentian Medja – Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Klodian Kurushi - Gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Klodiana Veizi – Gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;
- Manjola Xhaxho – Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Margarita Buhali – Gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë;
- Saida Dollani - Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Sokol Ibi – Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë;
- Sokol Ngresi – Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë;
- Erjon Çela – Gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë;
- Miliana Muça - Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Daniela Shirka - Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Iliriana Olldashi - Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Alma Ahmeti – Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës;
- Arta Duka - Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
- Elona Mihali - Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- Irida Kacerja - Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- Igerta Hysi - Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
- Migena Laska – Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Ornela Naqellari – Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
- Ilir Përdeda – Gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
- Erjon Bani – Gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Arbena Ahmeti – Gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Artur Kalaja – Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- Elona Toro - Gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- Etleva Temo - Gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë;
- Klodiana Gjyzari - Gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë;
- Mariana Shegani - Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;
- Nertina Kosova - Gjyqtare pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- Sandër Simoni - Gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Sokol Binaj - Gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- Asim Vokshi- Gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
- Luveda Dardha- Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër;
- Emona Muçi- Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec;
- Rezarta Aliu-Gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës;
- Sokol Pina- Gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë;
- Marsela Dervishi- Gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;
- Eriol Rroshi- Gjyqtar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë;
- Esmeralda Xhili – Gjyqtare pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnje;
- Lutfije Celami – Gjyqtare pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Berat;

Për të gjithë gjyqtarët për të cilët ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional sipas vendimeve të referuara më sipër, procesi ka vijuar me hapat përkatës sipas parashikimeve të Ligjit për Statusin dhe akteve nënligjore të Skemës së Vlerësimit, duke i dhënë përparësi gradimit dhe vlerësimit të përshpejtuar të detyruar të kandidatëve aplikues për ngritje në detyrë në Gjykatë të Lartë si dhe në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjatë vitit 2020, Komisioni ka paraqitur në Këshill projekt-aktet për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurave të vlerësimit të përshpejtuar për dy gjyqtarë, për shkak të tërheqjes së tyre nga kandidimi dhe për pasojë, rënies së shkakut për fillimin e procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, mbi bazën e të cilave janë miratuar vendimet si më poshtë:

37. Vendim nr. 609, datë 10.12.2020 “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren Elona Toro”.

38. Vendim nr. 610, datë 10.12.2020 “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional viti kalendarik 2019, për gjyqtaren Etleva Temo”.

c. Faktorë që kanë ndikuar në ecurinë e procesit të vlerësimit në vitin 2020.

Në referim të parashikimeve të nenit 90 dhe 91 të Ligjit për Statusin dhe Programin e Vlerësimit për vitin 2020, Gjykatat janë njoftuar në muajin janar të vitit 2020 për përgatitjen e tabelave me të dhëna statistikore për gjyqtarët e përfshirë në programin e vlerësimit.

Ky proces ka zgjatur në kohë për shkak të volumit të punës si dhe situatës së krijuar për shkak të pandemisë në muajin mars të vitit 2020 dhe në vijim, e cila ka sjellë si pasojë pezullimin e punës në gjykata për disa muaj.

Pas rifillimit të punës gjykatat kanë vijuar dërgimin e tabelave me të dhëna statistikore. Për disa nga gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë, ato plotësohen rishtazi pasi ata nuk janë pjesë e programit të vlerësimit për vitin 2020, sepse kanë mbi 15/vjet përvojë profesionale.

Pezullimi i punës së gjykatave në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 ka penguar për një periudhë disa mujore fillimin e procedurave të vlerësimit për gjyqtarët për shkak se fillimi i procedurës shoqërohet me zhvillimin e procedurës së shortit për përzgjedhjen e dosjeve për vlerësim, procedurë e cila zhvillohet në gjykatë.

Menjëherë pas rifillimit të punës në gjykata dhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor, KVEVP ka marrë të gjitha masat e nevojshme për fillimin e procedurës së vlerësimit për gradimin e gjyqtarëve për të cilët janë dërguar dosjet me aktet e vlerësimit profesional për përcaktimin e nivelit të vlerësimit. Aktualisht, procedura e vlerësimit ka filluar dhe është në progres për të gjithë gjyqtarët për të cilët organet e rivlerësimit kalimtar kanë përcjellë dosjet përkatëse në KLGj.

Lidhur me procedurën e vlerësimit etik dhe profesional sipas programit të vlerësimit për vitin 2020, ka filluar procedura e vlerësimit etik dhe profesional me procedure të përsheptuar të detyruar për të gjithë gjyqtarët që kanë aplikuar për ngritje në detyrë (në Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Posaçme dhe Gjykatat e Apelit) dhe për të cilët ka përfunduar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit.

Pavarësisht pengesave të hasura, KVEVP së bashku me Njësinë e Vlerësimit është angazhuar maksimalisht në marrjen e masave për ecurinë e procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për të cilët ka filluar procedura e vlerësimi. Diskutimi i projektraportëve të para të vlerësimit etik dhe profesional në Mbledhje Plenare ka filluar në muajin janar të vitit 2021, pas komunikimit të tyre gjyqtarëve në proces vlerësimi dhe dhënies së kohës së nevojshme për paraqitjen e kundërshtimeve në referim të nenit 94 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin), nenin 15 dhe 21 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”.

E. ÇËSHTJE TË TJERA

Komisioni ka trajtuar çdo kërkesë të paraqitur nga gjykatat, gjyqtarët dhe Institucione të tjera, që ka të bëjë me fushën e veprimtarisë së tij si dhe çdo çështje tjetër të adresuar pranë këtij Komisioni për trajtim, duke proceduar sipas rastit me përgatitjen e opinioneve ose kthimin e përgjigjeve përkatëse.

Disa nga çështjet e trajtuara janë si më poshtë:

- Administrimi i kërkesave për ushtrimin e veprimtarisë jashtë funksionit të gjyqtarëve, të cilat janë evidentuar në një regjistër elektronik të administruar pranë Njësisë së Burimeve Njerëzore;

- Dhënie mendimi në lidhje me propozimin për ndryshime në nenin 77 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, opinion i cili është marrë në konsideratë dhe miratuar me ligjin nr.149/2020, datë 17.12.2020.
- Trajtim i kërkesave të gjyqtarëve dhe institucioneve lidhur me çështje të cilat përfshihen në veprimtarinë e KVEVP apo kompetenca të tjera të Këshillit, për të cilat është hartuar kthim përgjigje apo adresuar për zgjidhje problematika e bërë prezent.

III. OBJEKTIVAT E KVEVP PËR VITIN 2021

1. Miratimi i standardeve të etikës gjyqësore dhe rregullave të sjelljes së gjyqtarëve ;
2. Miratimi i rregullave të detajuara për ushtrimin e veprimtarive jashtë funksionit ;
3. Miratimi i akteve plotësuese të Skemës së Vlerësimit Etik dhe Profesional për ndihmësmagjistratët në Gjykatën e Lartë dhe gjyqtarët e komanduar në KLGJ;
4. Vlerësimi me prioritet i gjyqtarëve që aplikojnë për ngritje në detyrë ;
5. Vazhdimi i procedurave të vlerësimit me qëllim gradimi për gjyqtarët e konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë;
6. Fillimi dhe përfundimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional për të gjithë gjyqtarët e përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2021.